

## **Gjuhët kanë rëndësi**

**[NARRATOR]**

Gjuhët luajnë rol thelbësor në promovimin e dialogut ndërkulturor. Njohja e gjuhëve të ndryshme forcon bashkëpunimin ndërmjet grupeve. E kur gjuhët zbehen, zbehet edhe begatia e diversitetit kulturor botëror.

Në Kosovë, mund të degjohet gjuha shqipe, serbe, turke dhe rome. E në Evropë fliten rreth 225 gjuhë burimore. 26 shtatori është Dita Evropiane e Gjuhëve. Për ta shënuar këtë datë, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë - apo OSBE organizoi një ngjarje në Prishtinë.

Ambasadori Jean-Claude Schlumberger, shefi i misionit të OSBE-së në Kosovë, pati këtë për të thënë:

**[JEAN-CLAUDE SCHLUMBERGER]**

Diversiteti gjuhësor në Evropë është shumë i rëndësishëm dhe natyrisht Kosova është në zemër të Evropës. Është mënyrë e natyrshme e kuptimit më të mirë, hapjes së perspektivës për të ardhme, sidomos për brezat e rinj. Sa më shumë gjuhë që flitni, aq më mirë do të ballafaqoheni me jetën në të ardhmen.

**[NARRATOR]**

Tim Cartwright udhëheq zyrën e Këshillit të Evropës në Prishtinë.

**[TIM CARTWRIGHT]**

Gjuha është portali. Është porta e kulturës. Gjuha është porta e kuptimit të ndërsjellë. Shumëgjuhësia, në një kontekst si Kosova, është kyçe për një shoqëri të suksesshme dhe kohezive.

**[NARRATOR]**

Annamaria Mecinaj është drejtoreshë e një qendre në Prishtinë që ofron mësim të gjermanishtes. Ajo është gjysmë gjermane dhe gjysmë hungareze dhe në gjuhën shqipe e tha këtë:

**[ANNAMARIA MECINAJ]**

E di rëndësinë e gjuhës sepse e kam përjetuar vetë. Kam ardhur në Kosovë para tetë viteve dhe e mësova gjuhën shumë shpejtë. Gjuha ishte çelësi për t u integruar në shoqërinë e Kosovës dhe për t u punësuar. Kosovarët janë shumë mikpritës por janë edhe më shumë nëse e flisni gjuhën. E atëherë, dyert me të vërtetë hapen.

**[NARRATOR]**

Me fjalët e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara Ban Ki-moon: Le t i bashkojmë të gjithë forcat për të promovuar diversitetin gjuhësor dhe shumëgjuhësinë si element kyç në përpjekjet tona për të ndërtuar botë më të mirë dhe jetë të dinjitetshme për të gjithë.